



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nr. Prot

Tiranë më, 12.05.2022

Drejtuar: **“FUSHA” shpk me NIPT: J61922018S, Administrator Z. Shkëlqim Fusha** me Adresë: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga “Murat Toptani”, perballe Kinema Millenium, Godina nr. 3, Pedonalja, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-24125-04-05-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:” **Furnizim-Vendosje Drurë-Shkurre Dekorative**”, me fond limit: : **37 821 095** (tridhjetë e shtatëmilion e tetëqind e njetzet e njëmijë e nëntëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **24 muaj** nga data e lidhjes së marreveshjes kuadër..

Publikimet e mëparshme: **Nuk ka pasur**

Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 46 datë 11 Prill 2022**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertues si më poshtë vijon me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. AlbGarden shpk

K37513520N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **35 000 000** (tridhjetë e pesëmilion)) **lekë pa TVSH.**

42 000 000 (dyzet e dymilion) **lekë me TVSH.**

2. DEAN 09 shpk

L42122013C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **37 763 650** (tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**

45 316 380 (dyzet e pesë milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) **lekë me TVSH.**

3. FUSHA shpk

J61922018S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **35 996 500** (tridhjetë e pesë milion e nentëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**

43 195 800 (dyzet e tremilion e njëqind e nentëdhjetë e pesë mijë e tetëqind) **lekë me TVSH**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. AlbGarden shpk

K37513520N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **35 000 000** (tridhjetë e pesë milion)) **lekë pa TVSH.**

42 000 000 (dyzet e dymilion) **lekë me TVSH.**

Klasifikimi u bë për arsyet e mëposhtme:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk rezulton anomalisht e ulët.

-OE ALBGARDEN sh.p.k nuk plotëson pikën 2 – 'Kriteret e Veçanta të Kualifikimit', nënpika (a), 'Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit', sipas shtojcës 8. Pasi në formularin e vetë-deklarimit tek paragrafi përkatës mungojnë kokoret dhe kompletet e ndihmës së shpejtë, ashtu siç edhe kërkohet qartazi në pikën 2.3.8 të 'Kapacitetit Teknik'.

-OE ALBGARDEN sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3 'Kapaciteti Teknik', nënpika 2.3.8, pasi faturat e paraqitura për kokore dhe komplete të ndihmës së shpejtë nuk janë të sakta. Sqarojmë se fatura për kokore nuk përmban barcode i cili të vërtetojë fiskalizimin e saj, në të kundërt të faturës për komplete të ndihmës së shpejtë e cila e përmban barcodin.

Faturat janë paraqitur në një dokument të vetëm, pavaresisht se blerja e pretenduar është kryer në dy entitete biznesi të ndryshme. Asnjë nga faturat nuk vërtetohet se ky mall (kokore dhe komplete të ndihmës së shpejtë) janë blerë nga OE ALBGARDEN sh.p.k, pasi jo vetëm që OE nuk e ka deklaruar në formularin e vetë-deklarimit por edhe sepse faturat nuk vërtetojnë dorëzimin e mallit, për shkak të datës së pagesës disa ditë më pas në rastin e faturës së kompleteve të ndihmës së shpejtë, apo për shkak të mungesës së barcode në rastin e kokoreve.

2. DEAN 09 shpk

L42122013C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **37 763 650** (tridhjetë e shtatemilion e shtateqind e gjashtedhjetë e tremije e gjashteqind e pesedhjetë) **lekë pa TVSH**

45 316 380 (dyzet e pesemilion e treqind e gjashtembedhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) **lekë me TVSH.**

Klasifikimi u bë për arsyet e mëposhtme:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
 - Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
 - Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk rezulton anomalisht e ulët.
- a) OE ‘Dean-09 sh.p.k’ nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës ekonomike.
- b) OE ‘Dean-09 sh.p.k’ nuk ka paraqitur formularin përmbledhës së vetë-deklarimit sipas shtojcës 8.
- c) OE ‘Dean-09 sh.p.k’ nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST pasi kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: **(2019, 2020, 2021)** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.
- d) OE ‘Dean-09 sh.p.k’ nuk plotëson pikën 2.3 ‘Kapacitetin Teknik’, nënpika 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit.**
- e) OE ‘Dean-09 sh.p.k’ nuk plotëson pikën 2.3 ‘Kapacitetin Teknik’, nënpika 2.3.2, pasi nuk ka paraqitur me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik i cili duhet të ketë një eksperiencë punë jo me pak se 3 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të gjelbërimit, e vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse.

- f) OE 'Dean-09 sh.p.k' nuk plotëson pikën 2.3 'Kapacitetin Teknik', nënpika 2.3.3, pasi nuk ka paraqitur një vërtetim se disponon kualifikimet e duhura te stafit inxhinierik perkatës me eksperience pune te pakten **3 vjecare** per kryerjen e te gjitha sherbimeve siç kërkohet në DST.
- g) OE 'Dean-09 sh.p.k' nuk plotëson pikën 2.3 'Kapacitetin Teknik', nënpika 2.3.4, pasi nuk ka paraqitur një deklaratë e cila të vërtetojë të duhet të ketë të punësuar punonjës si me poshte:
- 1 (nje) Automakinist** i cili duhet te jetë i pajisur me dëshminë e aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT ose organe kompetente ne baze te ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar)..
- 1 (nj) Eskavatorist** i cili duhet te jetë i pajisur me dëshminë e aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT ose organe kompetente ne baze te ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar). .
- h) OE 'Dean-09 sh.p.k' nuk plotëson pikën 2.3 'Kapacitetin Teknik', nënpika 2.3.6, pasi nuk ka paraqitur certifikatat e kërkuara, përkatësisht:
- ISO 9001 – 2015** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë);
- ISO 14001 – 2015** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë);
- ISO 45001 – 2018** ose ekuivalente për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë);
- i) OE 'Dean-09 sh.p.k' nuk plotëson pikën 2.3 'Kapacitetin Teknik', nënpika 2.3.8, pasi nuk ka paraqitur vërtetim për kapacitetet teknike qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates. dhe sasitë përkatëse për mjetet të kërkuara në këtë pikë.
-

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se: **“FUSHA” shpk me NIPT: J61922018S, Administrator Z. Shkëlqim Fusha** me Adresë: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga “Murat Toptani”, perballe Kinema Millenium, Godina nr. 3, Pedonalja, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **35 996 500** (tridhjetë e pesëmilion e nentëqind e nentëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind) **lekë pa TVSH** dhe vlera totale: **43 195 800** (dyzet e tremilion e njëqind e nentëdhjetë e pesëmijë e teteqind) **lekë me TVSH** është identifikuar si Oferta më e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arlinda Binjaku